REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**

# Njoftim

**Berat, më 01 / 07/2021**

**Ora 11:00**

**Lënda:** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Berat në sallën e Këshillit Bashkiak

I nderuar këshilltar!

Ju njoftoj se ditën e Enjte më datë 01.07.2021 ,ora 11:00 do të zhvillohet mbledhja e rradhes së Këshillit Bashkiak ,e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të ligjit 139/2015,neni 53 pika 4),me këtë rend dite:

- ✓ **1.Relacion dhe Projektvendim:** "Mbi miratimin e bonusit të qirasë per familjen e znj. Anisa Çerçizi ".
- ✓ **2.Relacion dhe Projektvendim:** "Mbi miratimin e strehimit të familjes së znj. Eglantina Subashi në banesat sociale me qira"
- ✓ **3. Relacion dhe Projektvendim:** "Mbi një ndryshim në VKB nr.31,datë 26.05.2021 " Mbi miratimin e dhënies me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri të pasurisë në pronësi të Bashkisë Berat ".
- ✓ **4.Relacion dhe Projektvendim:** " Mbi miratimin e fondit për ndërhyrjen në riparimin e dëmeve në varrezat publike te shkaktuar nga fatkeqesi natyrore. nga buxheti i bashkise, fondi rezervë i vitit 2021"
- ✓ **5. Relacion dhe Projektvendim:**Për miratimin e fushatës së partneritetit të Këshillit të Bashkisë me qytetarët
- ✓ **6. Relacion dhe Projektvendim:** Për një ndryshim në vendimin nr. 78, datë 29.12.2020 e Keshillit Bashkiak Berat dhe shprehjen e dakortësisë për heqjen nga fondi pyjor /kullosor të sipërfaqes prej 9.2663 ha, në ngastrat me nr . 191b, 190c, 190a . të Ekonomisë Pyjore Mali i Molishtit, Bashkia Berat".
- ✓ 7.Të ndryshme

- **Komisioni i Bujqësisë,Agro-Industrial,Kadastrës dhe Mjedisit** do te mblidhet ditën e enjte më datë 01/07/2021,ora 09:00 (në Bashki.)
- **Komisioni i Ekonomisë,Financës dhe Shërbimeve Sociale** do te mblidhet ditën e enjte më datë 01/07/2021,ora 09:30 (në Bashki. )

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**ERVIN CECA**

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKI ERAT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA BERAT**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## PROJEKTVENDIM

**Nr. _____, datë _________2021**

**MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PER FAMILJEN E ZNJ. ANISA ÇERÇIZI**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", VKM nr.384,datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore " dhe Vendimit të Komisionit të Strehimit të datës 15.06.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

## V E N D O S I :

1.Të miratoj , bonusin e qirase për familjen e znj. Anisa Çerçizi në vlerën 12,000 lekë /muaj me afat 1 vjeçar .

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Ervin Ceca**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA BERAT**
**DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, PRONAVE DHE TRANSPORTIT**

## RELACION

### MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PER FAMILJEN E ZNJ. ANISA ÇERÇIZI

Të nderuar Këshilltare !

Komisioni i Strehimit i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë mr.52, datë 28.01.2020 , mbledhur më datë 15.06.2021, mori në shqyrtim problemin e strehimit për familjen Znj. Anisa Çerçizi, referuar nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë si dhe nga psikologia e Shkollës 9-Vjeçare "Thimi Tani"

Znj.Anisa Çerçizi me tre fëmijë, është në procedurat e divorcit me ish- bashkëshortin nga qyteti i Lushnjes i cili e ka braktisur duke u larguar në Gjermani.

Nuk mund të qëndronte në banesën e prindërve të bashkëshortit deri në përfundim të procedurave të divorcit ,pasi ata nuk e kishin pranuar asnjëherë si nusen e tyre ,pasi i përkiste një komuniteti tjetër . E gjendur në këto kushte pa asnjë ndihmë financiare ka marrë fëmijët dhe është kthyer në familjen e origjinës në qytetin e Kuçovës.Pas disa javësh ajo njhet me z.Edmond Mehmetin nga qyteti I Beratit , i cili jetonte me nënën dhe dy fëmijët e vëllait ,të ardhur në jetë nga një bashkëjetesë e dështuar në lagjen 'Jani Vruho " Berat.

Të tre fëmijët e znj.Anisa Çerçizi ,K. Çerçizi (djali) i datëlindjes 04.10.2010, K. Çerçizi (vajza ) e datëlindjes 2011 dhe D. Çerçizi (djali) i datëlindjes 2016,flenë në të njëjtin ambjent me fëmijët e tjerë të familjes ,K.Metani 17 vjeç dhe A.Metani 12 vjeç,të cilët janë adoleshentë.

Kjo ngre shqetësim të madh për nënën e fëmijëve por edhe institucionin arsimor ,pasi mosha e nipit të bashkëjetuesit është problematike ,fëmijët nuk kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin dhe kjo mund të na sjellë në të ardhmen ndonjë ngacmim seksual apo edhe më keq abuzim seksual.

Nga sa më sipër komisioni i strehimit në mbledhjen e datë 15.06.2021 shqyrtoi rastin në fjale dhe miratoi bonusin e qirasë për këtë familje për një vit ,si familje me probleme sociale dhe ekonomike .

Nga Drejtoria e Shërbimit Social u bë e mundur që kjo familje të trajtohet me ndihme ekonomike.

Bashkëlidhur keni dy relacionet për këtë familje ,të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social e Bashkisë si dhe nga Njësia e Shërbimit Psiko-Social e Shkollës 9- Vjeçare " Thimi Tani".

Drejtor i E.P.T
Erlin Kuçi

Adresa:Blvd. "Republika ", Berat 5001.Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935.ëebsite: ëëë.bashkiaberat.gov.al. Email : bashkiaberat@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr: 2490 Prot.

Berat me 18.05.2021

**Lënda:** Relacion social-ekonomik për familjen Çerçizi

**DREJTORISË SË EMERGJENCAVE DHE STREHIMIT**
**BASHKIA BERAT**

Njësia e Shërbimit Psiko-Social pranë Zyrës Vendore Arsimore Berat, ka referuar në NJMF rastin e dy fëmijëve të familjes Çerçizi. Familja është identifikuar në kushte të vështira sociale dhe ekonomike. Pas vizitës dhe vlerësimit në familje edhe nga Administratoria Shoqërore e Rajonit 3 dhe PMF, u identifikua problematika kryesore, strehimi i sigurt, i referuara edhe nga psikologian shkollore.

Në këto kushte, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijëve, të drejtën për strehim të sigurt, kushtet aktuale të familjes, mbështetjen dhe fuqizimin e saj, referohet për mundësinë e aplikimit për të përfituar nga programi i banesave sociale me qira, nëpërmjet subvencionimit të qirasë në treg të lire.

Bashkëngjitur këtij dokumenti do të keni edhe vlerësimin e situatës soacial-ekonomike të familjes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**
**ARISA TOSKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORCW
ZYRA VENDORE ARSIMORE BERAT
Njësia e Shërbimi Psiko-Social

**SHKOLLA 9 – VJECARE "THIMI TANI"**

**30.04.2021**

**Relacion :**

**Lenda**

**Drejtuar :Nnjësia e Mbrojtjes të Fëmijës**

Nxënësit K.Cercizi i datëlindjes 04.10.2010,K.Cercizi 11.11.2011 janë regjistruar në shkollën -9 Vjecare "Thimi Tani" këtë vit shkollor 2020-2021.

Të dy fëmijët janë vëzhguar nga psikologia e shkollës që në fillim të procesit mësimor ,pas referimit të mësueseve kujdestare ,si nxënës të ardhur në shkolla të tjera.

Si nga mësueset kujdestare ku studionin fëmijët dhe nga psikologia e shkollës u vu re se ata ,u përshtatën shumë shpejt me bashkëmoshatarët dhe procesin mësimor.

Në fund të muajit Janar, mësueset kanë referuar nxënësit tek psikologia si nxënës me tendencë braktisje, pas komunikimeve të përditshme me nënën e cila herë e hapte telefonin dhe herë jo ,psikologia së bashku me mësueset kujdestare kanë shkuar në banesën ku jetonin nxënësit , kanë marrë takim me nënën e nxënësve ku morëm informacion në lidhje me dinamikat e familjes si dhe problemet financiare që kishte familja , kjo ndikonte edhe në mos ardhjen e fëmijëve në shkollë ,shkak mungesa e veshmbathjeve.

Pas marrjes të informacionit nga nëna e fëmijës e cila nuk paguhej as me ansistencë sociale për faktin se vaxhdonte të kishte gjëndjen civile ne Lushnje ,ajo u shpreh se nuk mund të bënte zgjidhjen e marteses pasi nuk kishte mundësi ekonomike,psikologia duke vënë në djeni drejtorin e shkollës z.Gjergji Daja ,ka kërkuar ndihmë juridike në një qendër që jep shërbime falas në

shtresat vunerabël, Studio Ligjore Falas "TLAS "e cila mori përsipër të gjitha shpenzimet për të mbyllur procesin gjyqësor të zonjës. Vizitat në familje kanë qënë të përhershme dhe në orare të ndryshme gjithmonë kur nxënësit mungonin

U hartua një plan ndërhyrje për të dy nxënësit nga psikologia dhe grupi mbështetës në shkollë, në lidhje me tendencën e baraktisjes.

Kjo ka sjellë gradualish,frekuentim të shkollës nga të dy nxënësit

Të dy nxënësit (vëllae motër)janë mbajtër në vëzhgim gjatë ambjenteve të shkollës.Fëmijët paraqesin një zhvillim fizik, kognitiv , socio-emocional e gjuhësor në përputhje me moshën e tyre biologjike e konform sferave të zhvillimit.

Nga vëzhgimi i jashtëm pavarsisht problemeve financiare paraqiten te veshur thjeshtë,përshtatshëm për moshën dhe kushtet klimaterike. Gjithashtu higjena e kujdesi vetjak shfaqet e përshtatshme.. Gjatë kontakteve të mëtejshme dhe takimit ballë për ballë nuk shfaqën rezistencë për të ndarë informacion në lidhje me situatën në të cilën familja aktualisht ndodhet.K.(vajza) preferonte ti kthente përgjigje cdo pyetje që i drejtohej në lidhje me ndjesitë e saj emocionale, kohën e saj të lirë, shoqërinë që frekuenton apo marrëdhënien me nënën. Gjithashtu preferon ti përgjigjet pyetjeve të mbyllura, dhe nëse i kërkohej një përgjigje më e detajuar në lidhje me jetesën e saj dhe ndërveprimet me familjarët e tjerë që ndodhen në banesë . Nxënësja mban kontakt të rregullt me sytë kur i drejtohej një pyetje apo në bisedë të lirë dhe nuk ndihej e besdisur nga pyetjet e drejtuara . K(djali) ishte më I rezervuar në lidhje me kthimin e përgjigjeve kur flitej për marëdhëniet në familjen ku jetonin aktualisht . Ai shprehte dëshirën që të jetonte në një banesë më vete ku të kishhte hapësira për të studiuar e qëndruar duke u shprehur se shpesh I binte të qëndronte tek dera e dhomës pasi nuk kishte ku të ulej në atë ambjent.

Nga të dhënat e marra nga mësueset kujdestare dhe nga vëzhgimet në klasë , vihet re se nxënësit kanë rezultate të mira në mësime edhe pse nuk kanë mundësi dhe kushte të përshtatshme për të mësuar .Krijimi I kushteve duke

pasur një ambjent për të mësuar do të sillte frekuentim të rregullt të shkollës dhe rritje akademike për nxënësit,pasi kanë kapacitete, shfaqin inteligjencë të mirë në lidhje me kuptimin e gjërave në mënyrën e duhur

**TË DHENA MBI FAMILJEN**

Familja Cercizi ka jetuar fillimisht në Qytetin e Sarandës , më pas janë kthyer në Kucovë kanë qëndruar rreth një vit , kanë shkuar në Turqi si emigrant ekonimik ,janë kthyer përsëri pas një viti ,kanë qëndruar në Gjermani në azilë për 4 vjet ,nuk mundën që të siguronin dokumenta janë kthyer të detyruar nga autoritet gjermane ,në banesën e prindërve të bashkëshortit në qytetin e Lushnjës.

Nëna e nxënësve K.Cercizi dhe K,Cercizi relatoi se regjistruan fëmijët në shkollë jetonin në një banesë me qira në Lushnje, pasi nuk mund të qëndronin në banesën e prindërve të bashkëshortit , ata nuk e kishin pranuar asnjëherë Anisën si nusen e tyre, pasi i përkiste një komuniteti tjetër .Gjëndja ekonomike u vështirsua edhe më tepër , babai i fëmijë ka shkuar përsëri në Gjermani ,por këtë herë pa bashkëshorten dhe fëmijët , fillimisht dërgonte të ardhura më pas nuk interesohej më për të dhe fëmijët , Znj,Anisa u shpreh se , u informua se ai kishte filluar një bashkëjetesë të re , e ka marrë në telefon dhe e ka pyetur nëse kjo ishte e vërtetë , është pohuar edhe nga vetë bashkëshorti që po bashkjetonte me dikë tjetër. E gjendur në këto kushte pa asnjë ndihmë financiare dhe me fëmijë të vegjël që donin përkujdesje.Anisa(nëna)ka marrë fëmijët dhe është kthyer familjen e origjinës në qytetin e Kucovës. Pas disa javësh , në Qershor të vitit 2020, ajo njihet me z,Edmont Mehmeti i cili jetonte me nënën dhe dy fëmijët e vëllait të ardhur në jetë nga një bashkjetesë e dështuar në lagjen"Jani Vruho"Berat.

Banesa në të cilën jeton nëna dhe fëmijët është e përbërë nga dy dhoma dhe një koridor lidhës mes dhomave ,tualet. Vizita është kryer në dhomën të cilën familja e quan kuzhinë, edhe pse nuk ka orenditë e një kuzhine. Vihej re se nëna përpiqej të kishte një higjenë të mirë në banesë.

Në banesë edhe pse kishte orendi shtëpiake, lagështira në të dyja dhomat ishte e dukshme dhe nëna relatoi se gjatë periudhës së dimrit njëra prej

dhomave kishte edhe rrjedhje shiu. Dyshemeja e banesës ishte e shktruar vetëm me beton. Vihej re se fëmijët nuk kishte hapësira të përshtatshme krahasimisht me moshën,në këtë banesë aktualisht jetojnë 8 persona.

Të tre fëmijët e Znj .Anisa, K .Cercizi(djali) i datëlindjes 04.10.2010, K.Cercizi(vajza) e datëlindjes 11.11.2011dhe D. Cercizi (djali) i datëlindjes 07.01.2016, flenë në të njëjtin ambjent me fëmijët e tjerë të familjes, K. Metani 17 vjec dhe A. Metani12 vjec, të cilët janë adoleshentë, kjo ngre një shqetësim të madh si për nënën e fëmijëve dhe ne si institucion arsimor,mosha e nipit të bashkjetuesit është problematike ,fëmijët nuk kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin dhe kjo mund të na sjellë në të ardhmen ndonjë ngacmim seksual apo edhe më keq abuzim seksual .

**Psikologe ;Bujana Nurellari** **Drejtor :Gjergji Baja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**
**DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, PRONAVE DHE TRANSPORTIT**

# RELACION

## MBI MIRATIMIN E STREHIMIT NË BANESAT SOCIALE ME QIRA TË FAMILJES SË ZNJ. EGLANTINA SUBASHI

**Te nderuar Keshilltare !**

Komisioni i Strehimit i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë mr.52, datë 28.01.2020 , mbledhur më datë 15.06.2021, mori në shqyrtim kërkesat e aplikantëve, për strehim në banesat sociale, me qëllim strehimin e njërit prej tyre , në apartamentit me nr.20,kati i pestë ,banesa sociale nr.2 .

Në këtë apartament me Vendimin të Këshillit Bashkiak nr.38,datë 29.07.2011,ishte strehuar deri tani familja e z.Arben Ziraj i cili e dorëzoj apartamentin më datë 01.06.2021 për arsye personale .

Mbështetur në kërkesat e qytetareve që kanë aplikuar për t'u strehuar në banesat sociale si dhe në sistemin e pikëzimit të miratuar me vkb në të cilin merret parasysh për cdo aplikantë ,kushtet e strehimit, kushtet familjare , kushtet sociale si dhe kushtet ekonomike, komisioni mori ne shqyrtim familjet e pastreha si më poshtë:

1. Eglantina Subashi ,rast i referuar nga Drejtoria e Shërbimit Social , viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare nga ish –bashkëshorti i saj R.C .Bashkëlidhur kemi shkresën e Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë nr. 2879, datë 01.06.2021 "Referim rasti për strehim"
2. Zamira Caka ,gjendja familjare 5 (pesë ) persona ,statusi social k/familjari PAK ,aktualisht trajtohet nga bashkia prej dy vitesh me bonus qiraje
3. Arjana Xheladini familje e përbërë nga dy persona në moshë madhore ,vet k/familjare PAK strehuar në një garsonierë te Banesa Sociale nr.1,kërkon të strehohet në një apartament 1+1 ,pasi edhe djali është në moshë madhore .
4. Lulëzim Berisha gjendja familjare 5 (pesë ) persona ,statusi social në përbërje familjare një PAK ,banon në një banesë me qira por nuk është trajtuar me bonus qiraje për shkak të mosdorëzimit të dokumentacionit nga ana e tij.
5. Florije Ruçi ,familje e përbërë nga dy persona të dy bashkëshortët PAK, aktualisht trajtohet nga bashkia prej dy vitesh me bonus qiraje .

Në përfundim **Komisioni i Strehimit vendosi si më poshtë:**

1. Të strehojë familjen e znj. Eglantina Subashi në apartamentin nr.20,me strukturë 1dhomë+1kuzhinë, kati i pestë ,banesa sociale nr.1 .

Drejtor i E.P.T
Erlin Kuçi
Ekuçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVENDIM**

**Nr. ______, datë __________2021**

**MBI MIRATIMIN E STREHIMIT NË BANESAT SOCIALE ME QIRA TË FAMILJES SË ZNJ.EGLANTINA SUBASHI**

Kryetari i Bashkisë mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8/2 , neni 24/2, neni 9 pika 1.1 gërma "b", neni 64 gërma "c" ; ligjin nr. 22/2018 " Për strehimin social " i ndryshuar , VKM nr.384,datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore " dhe Vendimit të Komisionit të Strehimit të datës 15.06.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI:**

1. Të strehojë familjen e znj. Eglantina Subashi në apartamentin nr.20, me strukturë 1dhomë + 1 kuzhinë, kati i pestë , banesa sociale nr.1 , apartament i liruar nga z.Arben Ziraj.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave, Pronave dhe Transportit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin Ceca**

Adresa :Blvd. 'Republika'.Berat.Shqipëri, Tel/ 00355 (0) 2 32 34 935, www.bashkiaberat.gov.al, bashkiaberat@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

**Nr. ______, datë __________2021**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VKB NR.31,DATË 26.05.2021 " MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM SHQIPËRI TË PASURISË NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 9 pika 1.2 "Të drejtat dhe përgjegjësitë" nënpika "a" dhe "c", Nenit 27 pika 1,2,5, Neni 54 pika 'e' dhe Neni 55 pika 4 si dhe ligjit 9693/2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar dhe VKM nr 433 datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administsrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave/Bashkive, pika 4 si dhe të VKM Nr 1064 datë 22.12.2020 "Për disa ndryshime në VKM Nr 391 datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" Shtojca 9", VKM Nr 54 datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" Kreu III pika 2. si dhe VKM nr 834 datë 21.11.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit" si dhe Ligjit Nr 24 datë 9.3.2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit",: me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ndryshimin e VKB-së nr.31,datë 26.05.2021 " Mbi miratimin e dhënies me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri në pronësi të Bashkisë Berat ", dhënien me qira nga 8 (tetë) pasuri në 24(njëzet e katër) pasuri .
2. Dhënien me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri të 24 pasurive të llojit kullotë, arë dhe kanal, në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat ,sipas listës bashkëlidhur projekt-vendimit.
3. Afati i qirasë për 24 pasuritë do të jetë ,për një periudhë 2 (dy vjeçare).
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Emergjencave , Pronave dhe Transportit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Ervin Ceca**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E EMERGJENCAVE ,PRONAVE DHE TRANSPORTIT

# RELACION

## MBI NJË NDRYSHIM NË VKB NR.31,DATË 26.05.2021 " MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM SHQIPËRI TË PASURISË NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT

**Të nderuar Këshilltarë !**

Shell Upstream Albania B.V. (SUA) është Operatori i Kontratës së Ndarjes së Prodhimit (PSC) të Bllokut 2-3 Shqipëri në tokë. Shell planifikon të kryejë shpimin e pusit (naftë dhe gaz natyror) të vlerësimit të Shpirag-5; 4 në Bllokun 2-3 në rajonin e Beratit, pranë Njësisë Administrative Sinjë të Bashkisë Berat.

Me vendimin nr. nr.31,datë 26.05.2021 " Mbi miratimin e dhënies me qira në favor të Shell Upstream Shqipëri të pasurisë në pronësi të Bashkisë Berat" , Ju miratuat dhënien me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri të tetë pasurive të llojit kullotë, arë dhe kanal, në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat.

Nga verifikimet e kryera në terren nga specialistet Shell Upstream Shqipëri, rezulton se preket edhe 14 pasuri të tjera të paluajtshme në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat, e llojit kullotë rrugë, kanale etj.

Shoqëria Shell Upstream Shqipëri, ka bërë kërkesë për marrjen me qira të 14 pasurive të tjera që preken nga zbatimi i projektit.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Ju miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.31,datë 26.05.2021 " Mbi miratimin e dhënies me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream shqipëri të pasurisë në pronësi të Bashkisë Berat", dhënien me qira nga 8(tetë) pasuri në 24 (njëzet e katër ) pasuri .

Bashkëlidhur, VKB nr.31,datë 26.05.2021 si dhe listën e pasurive që preken nga gjurma e projektit të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri kërkon ti marrë me qira , për një periudhë dy vjeçare .

Drejtori

Erlin Kuçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**

# V E N D I M

**NR 31 Datë 26/ 05/ 2021**

**MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM SHQIPËRI TË PASURISË NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 26.05.2021 mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 9 pika 1.2 "Të drejtat dhe përgjegjësitë" nënpika "a" Nenit 27 pika 1,2,5, Neni 54 pika 'e' dhe Neni 55 pika 4 si dhe ligjit 9693/2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar dhe VKM nr 433 datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administsrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave/Bashkive, pika 4 si dhe të VKM Nr 1064 datë 22.12.2020 "Për disa ndryshime në VKM Nr 391 datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" Shtojca 9", VKM Nr 54 datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" Kreu III pika 2. si dhe VKM nr 834 datë 21.11.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit" si dhe Ligjit Nr 24 datë 9.3.2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit",: me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

## VENDOSI

1. Të miratojë dhënien me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri të tetë pasurive të llojit kullotë, arë dhe kanal, në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat ,sipas listës bashkëlidhur projekt-vendimit.

2. Qiraja do të realizohet për të tetë pasuritë,për një periudhë 2 (dy vjeçare).

3.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Emergjencave , Pronave dhe Transportit.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË**

**ERVIN CECA**

Vendimi u miratua me 16

_ vota kundër

_ vota abstenim

| Lista e Pasurive me qira në favor të Shell Upstram (SUA) | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Bashkia | Njësia Administrativ | Fshati | ZK | Nr. Parcele | Vol | Faqe | Pronar/Përdorues | Sip Totale e Parcelës | Sip Qira (m²) | Çmimi (lek/m²) | Vlera Qira Lek/Vit | Vlera Totale Lek (2 vjet) |
| 1 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 65 | 2 | 203 | Bashkia Berat | 38,700 | 16,971 | 118.80 | 2,016,155 | 4,032,310 |
| 2 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 103/27 | 7 | 114 | Bashkia Berat | 935 | 105 | 118.80 | 12,474 | 24,948 |
| 3 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 100/20 | 3 | 80 | Bashkia Berat | 2,630 | 382 | 118.80 | 45,382 | 90,763 |
| 4 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 225/18 | 5 | 81 | Bashkia Berat | 14,700 | 623 | 118.80 | 74,012 | 148,025 |
| 5 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 225/27 | 5 | 90 | Bashkia Berat | 2,150 | 1,121 | 118.80 | 133,175 | 266,350 |
| 6 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 225/12 | 5 | 75 | Bashkia Berat | 1,520 | 1,144 | 118.80 | 135,907 | 271,814 |
| 7 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 223 | 5 | 63 | Bashkia Berat | 6,100 | 772 | 118.80 | 91,714 | 183,427 |
| 8 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 247 | 6 | 154 | Bashkia Berat | 5,100 | 1,950 | 118.80 | 231,660 | 463,320 |
| 9 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 250/2 | 5 | 200 | Bashkia Berat | 700 | 33 | 118.80 | 3,920 | 7,841 |
| 10 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 250/28 | 7 | 77 | Bashkia Berat | 670 | 180 | 118.80 | 21,384 | 42,768 |
| 11 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 263/11 | 6 | 69 | Bashkia Berat | 1,750 | 198 | 118.80 | 23,522 | 47,045 |
| 12 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 263/12 | 6 | 70 | Bashkia Berat | 7,100 | 615 | 118.80 | 73,062 | 146,124 |
| 13 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 286/17 | 7 | 120 | Bashkia Berat | 2,050 | 150 | 118.80 | 17,820 | 35,640 |
| 14 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 286/5 | 6 | 108 | Bashkia Berat | 882 | 150 | 600.00 | 90,000 | 180,000 |
| 15 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 269/1 | 6 | 77 | Bashkia Berat | 13,500 | 134 | 118.80 | 15,919 | 31,838 |
| 16 | Berat | Sinjë | Mbreshtan | 2634 | 260/1 | 6 | 55 | Bashkia Berat | 129,250 | 1,707 | 118.80 | 202,792 | 405,583 |
| | **Totali** | | | | | | | | | **26,235** | | **3,188,898** | **6,377,796** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK

# PROJEKTVENDIM

Nr. ______, datë __________2021

## MBI MIRATIMIN E FONDIT PER NDERHYRJEN NE RIPARIMIN E DEMEVE NE VARREZAT PUBLIKE TE SHKAKTUAR NGA FATKEQESI NATYRORE.

Mbështetur në ne Ligjin nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore" neni 7, neni 8 , neni 9, neni 54, neni 64/c ; Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrit te Financave nr. 2 date 06.02.2012 "Për procedurat standarde te zbatimit te buxhetit", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 81 Date 29 .12.2020 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2021" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

## VENDOSI:

1. Te miratoje projekt preventivat per zhdemtimin e demeve te shkaktuara ne varrezat Burdullias ne shumen **99185** leke, si me poshte :

   - Qivuri i te ndjereve Ilia & Varvara Xoxe vlera e demtimit 15258 leke
   - Qivuri i te ndjereve Llambrini & Sotir Bakalli vlera e demtimit 818 leke
   - Qivuri i te ndjereve Jani & Antiogoni Cimbidhi vlera e demtimit 10511 leke
   - Qivuri i te ndjereve Ilia & Urani Samarxhiu & Vasillaq Apostoli vlera e demtimit 22509 leke
   - Qivuri i te ndjeres Shaban & Besnik Lapardhaja } vlera e demtimit 33558 leke

2. Shuma prej 99185 leke do te përballohet nga Fondi rezerve i bashkise planifikuar per vitin 2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës , Drejtoria Emergjencave Civile Transportit dhe Pronave. dhe sherbimeve.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin Ceca**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE TRANSPORTIT PRONAVE DHE SHERBIMEVE**

# RELACION

## MBI MIRATIMIN E FONDIT PER NDERHYRJEN NE RIPARIMIN E DEMEVE NE VARREZAT PUBLIKE TE SHKAKTUAR NGA FATKEQESI NATYRORE.

Te nderuar Keshilltare!

Date 04.02.2021 ne varrezat Burdullias, Berat rrezohet nje pishe e kalbur

Pema duke rene brenda parceles ka sjelle demtimin e disa qivureve te te ndjereve si me poshte :

1. Ilia & Varvara Xoxe - koka e qivurit prej mermeri { 40 x 60 cm }me 32 germa te gdhendura; kollona vertikale 2 x(57 x20 ) cm.
2. Llambrini & Sotir Bakalli - nje pjese e pllakes se siperme me permasa (15 x64 ) cm .
3. Jani & Antiogoni Cimbidhi – koka e qivurit prej guri me permasa ( 60x40 ) cm me 40 germa te gdhendura ; pllaka e kollones 2x ( 22x60 )cm ; pllaka guri me permasa ( 60x40 ) cm
4. Ilia & Urani Samarxhiu & Vasillaq Apostoli - koka e qivurit mermer (52x56 ) cm; kollona e djathte ( 65x 10x10 ) cm ; pllaka poshte kokes se qivurrit mermer me permasa ( 65 x 15 ) cm ; germa te gdhendura 62 cope .
